

PROCESVERBAL
nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 5.5.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivoli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Magdalena Davidovska-Dovleva, Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Vesna Simonovska, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 15-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

U propozua që pika nën "Të ndryshme" e rendit të ditës, me titull "Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit Total TV ShPK Shkup, për shkelje të nenit 141 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, të shqyrtohet si Pika 3, ndërsa pikat e mbetura të rinumërohen në përputhje me rrethanat, përkatësisht të zhvendosen një vend përpara".

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 27.4.2026.
2. Shqyrtimi i raporteve tremujore mbi punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 janar deri më 31 mars 2026.
3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit Total TV ShPK Shkup, për shkelje të nenit 141 të Ligjit për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: pajisje të sistemit për monitorimin e reklamave politike me pagesë.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe, me 6 vota "pro" dhe një "abstenim" nga Petar Xhurovski, miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 27.4.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Dragica Ljubevska, theksoi se në periudhën nga 1 janar deri më 31 mars 2026, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizue ka realizuar disa aktivitete në kuadër të kompetencave të saj ligjore. Në fillim të vitit, vazhdoi me monitorim të reklamave politike me pagesë në shtatë televizione dhe dy radio në lidhje me zgjedhjet e përsëritura lokale, gjatë të cilave u monitorua edhe heshtja zgjedhore. Raporti për transmetimin e reklamave politike me pagesë iu dorëzua Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar me ligj. Drejtuar TV Kompani 21-M iu referua sugjerim për mospërbushje të detyrimeve të Kodit Zgjedhor në pjesën e ofrimit të përmbajtjeve të arritshme për procesin zgjedhor. Në periudhën raportuese, u realizuan mbikëqyrja programore dhe administrative mbi Nasha TV, TV 24 Vesti, TV Kompani 21-M dhe TV Shenja. Tek TV Kompani 21 -M u konstatuan shkelje në lidhje me mbrojtjen e të miturve, rregullat për plasim të produkteve dhe detyrimin për publikim impresium. Mbikëqyrje të kontrollit programor mbi Radio Modea, gjatë së cilës u konstatua se transmetuesi ka mënjeluar shkeljen e konstatuar më parë lidhur me komunikimet komerciale. Plotësuese, sipas detyrës zyrtare është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme mbi programin muzikor për fëmijë - festivalin " Bilbilite na Korab"(Bilbilat e Korabit), transmetuar në RTM2 më 28.4.2026, gjatë së cilës u konstatua shkelje e dispozitave të nenit 48 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Në tremujorin e parë, u kryen gjithsej 23 mbikëqyrje të rregullta mbi operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik, gjatë të cilave nuk u konstatun shkelje. Mbikëqyrje për përmbushjen e kushteve minimale kadrovike u kryen në TV Plus, TV Edo, TV Sonce dhe Nasha TV. Në këtë drejtim, leja për TV Sonce është hequr, ndërsa TV Edo dhe Nasha TV dorëzuan dokumentacion përkatës që konfirmonte përmbushjen e kushteve, prandaj procedurat për heqjen e lejeve nuk u iniciuan. Agjencia realizoi tre mbikëqyrje të rregullta administrative mbi botuesit e mediave të shtypit dhe gjashtë mbikëqyrje mbi mediat online - portalet e internetit, në lidhje me detyrimin për publikim impresium. Shkelje u konstatuan tek katër botues të mediave. Sa i përket strukturës pronësore u miratua ndryshim tek Radio Vati, ndërsa për TV Shutel u miratua konkluzion se Vendimi i miratuar më parë nuk prodhon veprim juridik, për shkak të moszbatimit të ndryshimit në Regjistrin Qendror brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Me qëllim përmirësimin e transparencës, në faqen e internetit të Agjencisë u vendos baner i veçantë me të dhëna mbi strukturën pronësore të televizioneve, radiove, mediave të shtypit dhe mediave online. Gjatë kësaj periudhe, ndaj dy transmetues u vazhduan lejet për periudhë nëntëvjeçare. Plotësuese, botuesit e mediave online u përkujtuan për detyrimin për harmonizimin e kodit kryesor të të ardhurave me aktivitetet përkatëse botuese, me qëllim mbajtjen e statusit në Regjistrin e botuesve të mediave online. Gjatë periudhës së raportimit, Agjencia lëshoi gjithsej 74 çertifikata për regjistrimin e paketave programore. U përgatë

analiza e tregut mediatik në Maqedoni, si dhe hulumtimi i mendimit të audiencës. Takimi i parë publik i Agjencisë për vitin 2026 u mbajt më 30 mars. Sa i përket komunikimit me publikun, u publikuan disa njoftime, të cilat i referoheshin detyrimit për regjistrimin e influenserëve, sulmeve publike nga politikanë dhe bartës të funksioneve publike kundër gazetarëve dhe mediave, si dhe qëndrimit të papërshtatshëm të një gazetari ndaj Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Përfaqësues të Agjencisë morën pjesë në disa vebinare, punëtori dhe evente nga fusha e shërbimeve mediatike audiovizuale, për të cilat informacione më të hollësishme përmbajnë materialet e dorëzuar. Në tremujorin e kaluar u kryen dhe disa revizione të brendshme. Në lidhje me masat e shqiptuara, u miratuan gjithsej tre paralajmërime publike - dy për transmetuesit dhe një për botues të medias së shtypit.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se gjatë mbikëqyrjes së kryer ndaj operatorit Total TV ShPK Shkup, është konstatuar ritransmetim i disa shërbime programore për të cilat nuk është marrë miratim, përkatësisht nuk janë të mbuluar me çertifikatë për ritransmetim të shërbimeve programore vendase dhe të huaja. Duke pasur parasysh se kjo është shkelja e parë e konstatuar në vitin aktual, propozoi që operatorit t'i shqiptohet masë paralajmërim publik, dhe të urdhërohet që menjëherë t'i ndërpresë shërbimet programore për të cilat nuk posedon çertifikatë përkatëse nga Agjencia, pas së cilës do të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, pyeti nëse operatori ishte paralajmëruar paraprakisht, me shkrim apo gojarisht, për shkeljen e konstatuar.

Drejtori Trajčevski sqaroi se raporti nga mbikëqyrja e kryer publikohet në faqen e internetit të Agjencisë, dhe pasi Këshilli të miratojë masë paralajmërim publik, operatori do të njoftohet shtesë me shkrim.

Këshilltarja mr. Majnova, pyeti nëse bëhet fjalë për tre shërbime programore.

Drejtori Trajčevski sqaroi se kemi të bëjmë gjithsej me katër shërbime programore, prej të cilave një vendas dhe tre të huaj.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore të kryer me nr.11-1969/1 të datës 30.4.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për tregti dhe shërbime Total TV ShPK Shkup t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 141, paragrafi 13 i LShMAAV-së dhe, në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 të datës 1.10.2025, urdhëroi që menjëherë pas marrjes së Aktvendimit për paralajmërim publik të harmonizojë punën e saj me LShMAAV-së.

Mbikëqyrja konstatoi se Shoqëria për tregti dhe shërbime Total TV ShPK Shkup, e cila sipas njoftimit nga AKE mund të ushtrojë veprimtari në territorin e RMV-së, më 27 prill 2026, për përdoruesit e saj ritransmetoi shërbimet programore "TV Alfa", "Happy TV", "Animal Planet" dhe "Travel", të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të lëshuar nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi 13 të LShMAAV-së.

Spektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit të lartpërmendur.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvedimin për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim publik të parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike të Agjencisë për vitin 2026, për të cilin mjetet janë siguruar në Planin Financiar për vitin 2026. Në përputhje me vlerën e parashikuar të deklaruar në materialet e dorëzuara, procedura do të zbatohet si procedurë e hapur, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike, dhe do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizime publike dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Ajo shpjegoi se nevoja për zbatimin e furnizimit rrjedh nga nevoja për të siguruar parakushte teknike për vënien në funksion të sistemit për monitorimin e reklamave politike me pagesë, e cila është donacion nga Fondacioni Ndërkombëtar për sisteme zgjedhore (IFES), me ç'rast furnizimi i referohet një zgjidhjeje të specializuar softuerike, në përputhje me specifikimin teknik të përmbajtur në materiale.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, pyeti nëse softueri është donacion i plotë për Agjencinë, përkatësisht a është e nevojshme që Agjencia të sigurojë pajisjen hardver.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, sqaroi se softueri është donacion, por se Agjencia ka detyrimin të sigurojë kushte të përshtatshme teknike, përkatësisht hardver, për implementimin e tij. Plotësuese, informoi se furnizimi duhej të ishte shpallur më herët, por për shkak të rritjes së çmimeve në treg është shtyrë. Ai theksoi se ka pasiguri në lidhje me realizimin në kuadër të mjeteve të planifikuara dhe se, nëse nuk realizohet, do të jetë e nevojshme të ndryshohet Plani Financiar për vitin 2026 dhe të sigurohen mjete shtesë. Lidhur me afatet, Drejtori sqaroi se softueri do të dorëzohet gjatë muajit maj, pas së cilës do të fillojë periudha e garancisë prej 12-muajsh, ofruar nga donatori. Ai theksoi se nëse gjatë kësaj periudhe nuk sigurohet hardveri i nevojshëm, Agjencia nuk do të jetë në gjendje ta instalojë dhe testojë softuerin, as të shfrytëzon periudhën e mirëmbajtjes të mbuluar nga donatori.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, shtroj pyetje në lidhje me analizën e kryer për optimizimin e dikastereve ekzistuese, si dhe për arsyeshmërinë e dinamikës kohore të furnizimit, duke marrë parasysh se në vitin aktual nuk priten zgjedhje.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se sistemi ekzistues nuk i plotëson parakushtet teknike për instalimin e softuerit të donuar, prandaj është e nevojshme furnizimi me hardver të përshtatshëm. Ai theksoi se realizimi i furnizimit nuk kushtëzohet drejtpërdrejt nga mbajtja e zgjedhjeve, por nga nevoja për ta vënë në funksion softuerin dhe për ta testuar brenda periudhës së garancisë.

Këshilltarja Cvetanka Minovska shtroi pyetje në lidhje me përfitimet(benifitet) financiare të furnizimit, si dhe mundësinë e sigurimit të donacioni për hardverin.

Drejtori sqaroi se pyetja e zëvendësës së kryetarit i referohej analizës "kosto-benifit", jo përfitimeve të drejtpërdrejta financiare, dhe shprehu dyshime në lidhje me mundësinë e sigurimit të donacioni për pajisje hardver, duke marrë parasysh se procese të tilla janë afatgjata dhe të pasigurta. Ai gjithashtu theksoi se furnizimi është parashikuar tashmë në dokumentet e miratuara për planifikim të Agjencisë. Lidhur me përfitimet, ai vuri në dukje se softueri do të mundësojë përpunimin e automatizuar të reklamave politike me pagesë, duke lehtësuar ndjeshëm punën dhe duke minimizuar mundësinë e gabimeve.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Dragica Ljubevska, gjithashtu sqaroi se në fazën fillestare është marrë në konsideratë siguri i donacionit dhe për hardver, por kjo nuk është pranuar nga donatori, duke marrë parasysh kufizimet buxhetore dhe praktikën e bashkëfinancimit, sipas së cilës marrësi i donacionit merr pjesë me mjetet e veta.

Këshilli i Agjencisë, me 6 vota "pro" dhe një "abstenim" nga Zirjeta Jajaga, dha miratimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: pajisje hardver për monitorimin e reklamave politike me pagesë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik të lëndës - mallra: pajisje hardver për monitorimin e reklamave politike me pagesë, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr.05-869/1 të datës 4.3.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika "Të ndryshme"

Këshilltarja Gordana Majnova bëri pyetje në lidhje me rrjedhën e procedurës për ndryshimin e sistematizimit në Agjenci, përkatësisht nëse është formuar grup pune ose komision dhe nëse është parashikuar pjesëmarrja e ndonjë anëtari të Këshillit në punën e tij.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, sqaroi se komision formal ende nuk është formuar, por në proces do marrin pjesë aktive udhëheqësit e sektorëve të cilët deri më tani kanë mbajtur disa takime pune. Ai theksoi se pritet që rreth një muaji të përgatitet draft i sistematizimit i cili së pari në mënyrë joformale do t'u dorëzohet anëtarëve të Këshillit për shqyrtim. Pas kësaj, materiali do t'i nënshtrohet shqyrtimit zyrtar në seancë të Këshillit, me siguri gjatë muajit korrik ose shtator.

Lidhur me mundësinë e përfshirjes së anëtarëve të Këshillit, drejtori theksoi se kontributi i tyre do të jetë veçanërisht i rëndësishëm në fazën kur do ekziston draft-dokumenti konkret, pas së cilës mund të hapet diskutim thelbësor dhe mund të bëhen propozime dhe sugjerime konkrete.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani